



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.05.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Flutura Aça - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13 prill 2022.

1. Diskutimi dhe miratimi i projektrezolutës për Raportin e veprimtarisë 1-vjeçare për vitin 2021 të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

2. Diskutimi i kërkesës së një grupi deputetësh, anëtarë të komisionit, për zhvillimin e një seance dëgjimore me ekspertë për p.ligjin “Për miratimin e Marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”.

Marrin pjesë:

Flutura Aça, Petro Koçi, Besion Ajazi, Lindita Buxheli, Ilir Topi, Teuta Ramaj, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Florenc Spaho, Meri Markiçi, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Eralda Bano, Merita Baku dhe Kastriot Piroli.

Mungojnë:

Eduard Ndreca, Blerina Gjylameti, Luçiano Boçi dhe Agron Gjekmarkaj.

HAPET MBLEDHJA

Flutura Aça- Përshëndetje kolegë,

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet Informimit Publik të datës 11 maj.

Sot në rend të ditës kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 13 prill 2022, të cilin e keni në email; diskutimin dhe miratimin e projektrezolutës për raportin e veprimtarisë 1-vjeçare për vitin 2021 të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për të cilën kemi diskutuar gjatë në komision.

A jeni dakord me rendin e ditës? Dakord.

Miratohet.

Kush është dakord me procesverbalin e datës 11 maj? Dakord.

Miratohet.

Vazhdojmë me pikën 2 të rendit të ditë.

Përpara se ta diskutojmë rezolutën, ia kaloj fjalën zonjës Tahiraj.

Dasantila Tahiraj -Faleminderit, kryetare!

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi veprimtarinë e AMA-s për vitin 2021 dhe vlerëson Autoritetin e Mediave Audiovizive, i cili gjatë 21 vjet themelim u angazhua në fushën e medias së shkruar dhe audiovizive.

Sa i përket kësaj, Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 rekomandon që AMA të angazhohet veçanërisht në këto aspekte të veprimtarisë së saj:

1. AMA, menjëherë pas finalizimit të procesit të lirimit të brezit DD2 në fund të qershorit 2022, duhet të fillojë nga puna me procesin e rishikimit të tarifave për t'i dhënë zgjidhje problemit të tarifave të mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së nga operatorët lokalë, duke pasur parasysh edhe rëndësinë që ka në funksion të interesit publik vijueshmëria e transmetimeve televizive të televizioneve lokale, të cilat janë thelbësore për zhvillimin e demokracisë dhe përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme në sferën publike të një vendi.

2. AMA, gjatë punës për rishikimin e kodit të transmetimit, duhet të bashkëpunojë me të gjithë aktorët dhe faktorët përkatës, përfshirë edhe organizatat ndërkombëtare dhe mediet audiovizive për një kod të ri transmetimi, i cili të jetë sa më në koherencë me sfidat dhe zhvillimet në fushën e medias.

3. AMA duhet të propozojë ndryshimet e nevojshme lidhur me përmirësimin e legjislacionit për reklamat publike në përputhje me standardet ndërkombëtare. Është shumë e rëndësishme që të theksojmë reklamat që kanë të bëjnë me medikamentet mjekësor.

4. Duke qenë se, siç theksohet edhe në raportprogresin e fundit të KE-së, transparenca e financimit të medias duhet mbetet një objektivi kyç për të përmirësuar lirinë e medias në vend. AMA një ndër objektivat kryesore të punës së saj të ketë forcimin e mbikëqyrjes lidhur me çështjet e pronësisë dhe kontrollit të OSHMA-ve.

5. AMA, si një institucion me ekspertizën e duhur teknike, duhet të japë kontributin e saj gjatë fazës së rishikimit në Kuvend të ndryshimeve ligjore, sa i përket ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

6. AMA duhet të koordinojë punën edhe me institucionet e tjera, të cilat duhet të kontribuojnë për të bërë të mundur transmetimin e pjesshëm, brenda vitit 2022, të direktivës së BE-së 2010/13/BE “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, reklamën, juridiksionin, aksesueshmërinë e personit me aftësi të kufizuara e të tjerë.

7. AMA, në bashkëpunim me AKEP-in, OSHEE-në dhe Shoqatën e Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë dhe Valorë, duhet të punojë për gjetjen e rrugëzgjdhjeve lidhur me problematikën e heqjes nga shtyllat elektrike të kabllave të operatorëve kabllorë. Kjo është shumë e rëndësishme për të gjitha qytetet kudo ku ofrohet ky shërbim.

8. AMA duhet të vijojë të ndjekë çdo ankesë të qytetarëve apo grupeve të interesit, duke i vlerësuar me seriozitet. Fakti që numri i ankesave pranë këshillit të ankesave, që nga krijimi i tij në vitin 2016, ka pasur një rritje progresive nga viti në vit tregon për rritjen e besimit tek Autoriteti në funksion të interesit publik në transmetimet audiovizive

9. AMA duhet të vijojë të kërkojë marrjen e hapave konkretë e të shpejtë në lidhje me zgjidhjen e problemit të mungesës së interpretëve dhe përkthyesve për transmetimin me gjuhën e shenjave, duke theksuar që zgjidhja e kësaj çështje është një detyrim që garanton të drejtën e informimit, që është një çështje mjaft e ndjeshme për komunitetin me nevoja të veçanta shqisore.

10. AMA duhet të punojë për rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efikasitetit si rregullator, nëpërmjet zbatimit të proceseve dhe procedurave, që janë të hapura e të kontrollueshme, si dhe duke lehtësuar barrën burokratike, për subjektet që autoriteti licencon dhe autorizon. Këtu, kryesisht, bëhet fjalë për licencat që i jepen televizioneve dhe medieve lokale.

11. AMA duhet të vijojë të luajë një rol proaktiv, në bashkëpunimin me aktorët dhe faktorët përkatës, për të bërë të mundur forcimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punës dhe sociale të gazetarëve, si një çështje që ka ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias dhe kërkesë e përsëritur në raportprogresin KE-së.

Këto ishin disa nga rekomandimet për AMA-n.

Faleminderit!

Flutura Aça- Zonja Tahiraj, faleminderit!

Zonja Zhupa, fjala për ju.

Ina Zhupa- Faleminderit!

Në fakt, dje ishte dëgjesa me kryetaren e ANA-s, për të cilën kisha shumë pyetje dhe problematika për t'i ngritur, por duke u nisur nga fakti që pyetjet e deputetëve, në kundërshtim me atë që thotë Rregullorja dhe në kundërshtim me atë që është e drejta çdo deputeti, përzgjidheshin se kujt duhej t'i përgjigjej kryetarja dhe kujt nuk duhej t'i përgjigjej kryetarja nga drejtuesi i seancës, nisur edhe nga pyetjet që bëri zoti Boçi, për të mos ngelur peng i një monologu të programuar midis drejtuesve të maxhorancës dhe një përfaqësueseje politike, gjithashtu, të maxhorancës, si zëdhënësja e Edi Ramës sot, kryetarja e AMA-s, preferova që të mos bëhesha pjesë e farsës.

Për sa i përket raportit, i vlerësoj rekomandimet, por, në mirëkuptimin tuaj, dua t'ju propozoj edhe disa shtesa. Dy pika që janë të rëndësishme, në fakt, mund të bashkohen ose të ndahen më vete.

Së pari, e rëndësishme është që AMA të jetë më proaktive në rastet e dhunimit verbal ose fizik në kryet të detyrës së gazetarëve nga persona që ushtrojnë funksione publike apo persona që përfaqësojnë organet ligjzbatuese.

Së dyti, AMA duhet të analizojë më thellë dhe të monitorojë raportet për lirinë e medie, përfshirë edhe raportin e fundit të reporterëve pa kufi, në bashkëpunim me subjektet, të cilat ajo monitoron.

Së treti, monitorim më intensiv nga ana e AMA-s për veprimtarinë e Radiotelevizionit Publik Shqiptar, si një emirë publike, por edhe për faktin që ky institucion financohet nga taksat e publikut shqiptar.

Ama të kërkojë dhe të bëjë çdo përpjekje për plotësimin e detyrimit ligjor për përdorimin e gjuhës së shenjave, pasi komuniteti i njerëzve, të cilë nuk dëgjojnë, diskriminohen dhe privohen nga e drejta për informim, një e drejtë themelore e çdo individi.

AMA të bashkëpunojë më shumë me ministrinë, të cilat kanë në fushën e tyre, në këtë rast Ministria e Arsimit, por edhe të tjera, siç mund të jetë ajo e Rinisë, të përgjithësisë arsimit parauniversitar, arsimit e lartë, mbrojtjen e fëmijëve, shtresave në nevojë, me OJF-të që merren me këto veprimtari, me departamentet e gazetarisë dhe me të gjithë faktorët dhe aktorët, me qëllim reduktimin e fenomenit të bullizmit, abuzimit seksual, dhunës fizike dhe verbale që promovohen jo në pak raste në emisione apo programe të ndryshme televizive.

Këto ishin shtesat që propozoj. Në qoftë se do të gjejmë..

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e kuptoj kodin e transmetimit, por nuk është rasti kësaj pike që kërkoj unë. Në rastin e parë e mirëkuptova, por kjo është shumë më specifike dhe besoj se është në nderin tonë, si komision, por edhe si nënkryetare të grupit të fëmijëve që këto fenomene të bullizmit, abuzimit seksual të kenë më shumë mundësi që t'ia japim edhe si detyrë specifike AMA-s për monitorimin e programeve televizive.

Nuk janë aspak politike, por janë disa shtesa që janë në të mirë të punës dhe në nderin e këtij Komisioni.

Faleminderit!

Flutura Açka - Zonja Zhupa, faleminderit!

Enslemvera Zake - Faleminderit, kryetare!

Faleminderit relatores dhe kolegëve!

Ne jemi dakord me propozimet që kolegja tha. Njëra ishte pika 9, që është e njëjta dhe te pika 2, te kodi i transmetimit, ndoshta mund të riformulohet, siç e propozoi kolegja, dhe duke shtuar në referencë të kodit të transmetimit, sepse Kodi i transmetimit nuk përfshin vetëm ato që përmendi zonja Zhupa, por ka edhe shumë elemente të tjera, përveç bullizmit, gjuhës seksuale, barazia gjinore e të tjerë. prandaj, ne mund të shtojmë në referencë të kodit të transmetimit, i cili është më gjithëpërfshirës.

Lidhur me lirinë e medias, është pika e fundit, pika 11, të cilën zonja Zhupa e ripërsëriti dhe nuk besoj se ka ndonjë kundërshti.

Flutura Açka - Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Edhe unë jam parim me ato që propozoi kolegja Zhupa. Mendoj se zgjidhja është redaktimi. Në qoftë se ka diçka që mund të futet brenda këtyre pikave është një gjë e zgjidhshme, ndërkohë mund të shtohen edhe të tjera. Nuk e di kush do ta bëjë redaktimin.

Flutura Açka - Nëse vendosim për përfshirjen, unë do të merrem vetë, pa problem.

Petro Koçi - Unë kam një sugjerim. E kuptoj për mbrojtjen e gazetarëve, por të mos e specifikojmë dhe të themi për mbrojtjen nga njerëzit me pushtet. Mund të themi: “Në çdo rast që cenohet integriteti moral apo fizik i gazetarëve”, si, për shembull, kur u godit Anila Hoxha, ndoshta jo me qëllim, por çfarë rëndësie ka, aty ka pasur një reagim. Të mos e bëjmë ashtu, sepse duket sikur është i qëllimtë dhe më mirë ta themi në përgjithësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund ta shtojmë, nuk ka gjë. Për shembull, mund ta themi kur gazetari cenohet, sepse gazetari është nën goditjen e krimit, presioneve, nga njerëz politik të pushtetit, ekonomik, nga krimi. Këtu ka gazetarë të kronikës, që shpeshherë e ngacmojnë krimin. Kështu që mendoj se

është një pikë që ia vlen të vihet në vete, por pa e specifikuar, sepse duket sikur e kemi qëllimisht me policinë, ose me politikanët. E bëjmë të përgjithshme dhe unë jam dakord.

Flutura Aça - Faleminderit, zoti Koçi!

Po, zonja Zhupa.

Ina Zhupa - Ju falënderoj shumë kolegë të maxhorancës, zonja Zake dhe zoti Koçi!

Sigurisht, do të vë në dispozicion të kryetares mënyrën përfundimtare. Më vjen mirë që gjetëm këtë lloj dakordësie dhe specifikimet mund t'i eliminojmë, por u nisa nga rastet konkrete, prandaj më bënë të reflektoja. Specifikimet në këtë rast, edhe kur janë më gjithëpërfshirëse, do të na ndihmojnë edhe ne në monitorimet e ardhshme që do t'i bëjmë institucionit duke i evidentuar këto si pika që edhe ata duhet t'i kenë për t'i referua këtu sa herë ka seanca dëgjimore dhe raportime vjetore.

Shumë faleminderit!

Flutura Aça - Faleminderit, zonja Zhupa!

Kalojmë rezolutën me ndryshimet pastaj i integrojmë.

Zonja Ulliri ka diçka për të shtuar.

Andia Ulliri - Kam edhe diçka për të shtuar për sa i përket monitorimit më intensiv nga ana e AMA-s për veprimtarinë e RTSH-së, e cila do të ishte një e mirë publike...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, është përfshirë, por është vetëm në lidhje me operatorët lokalë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Pjesa tjetre është që komisioni të vihet në dijeni me veprimtarinë e RTSH-së, me operatorët privatë dhe sa është në përputhje me legjislacionet. Kështu që besoj se duhet të futet në një të tërë.

Flutura Aça - A jemi dakord me rezolutën në parim, bashkë me shtesat, të cilat do të pasqyrohen siç i vendosëm bashkë? Dakord.

Miratohet.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës

Sekretar
Besion Ajazi

Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Ariana Mero



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.05.2022, ora 11:20

Drejton mbledhjen:

Flutura Aça - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi i kërkesës së një grupi deputetësh, anëtarë të komisionit, për zhvillimin e një seance dëgjimore me ekspertë për p.ligjin “Për miratimin e Marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”.

Marrin pjesë:

Flutura Aça, Petro Koçi, Besion Ajazi, Lindita Buxheli, Ilir Topi, Teuta Ramaj, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Florenc Spaho, Meri Markiçi, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Eralda Bano, Merita Bakiu dhe Kastriot Piroli.

Mungojnë:

Eduard Ndreca, Blerina Gjylameti, Luçiano Boçi dhe Agron Gjekmarkaj.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Flutura Aça - Kam edhe diçka për të shtuar lidhur me datën 17, ku një grup i deputetëve të opozitës ka kërkuar seancë dëgjimore. Është mirë që këto gjëra t'i bëjmë transparente dhe të sinqerta. Nëse nuk krijohet kuorumi, ne turpërohemi para njerëzve shumë

të rëndësishëm të Shqipërisë. Kështu që ta vendosim këtë gjë dhe të mos bëjmë shaka. Nëse do ta bëjmë takimin, t'i ftojme njerëzit, në të kundërt, të mos i sjellim. Prandaj, më mirë është ta vendosim sot se çfarë do të bëjmë dhe të mos i zhgënjëjmë njerëzit dhe të tallemi me ta.

Ju faleminderit!

Petro Koçi - Sipas Rregullores, kur 1/3 e komisionit kërkon një mbledhje, ajo organizohet automatikisht. Ky është një proces, që ne e kemi kaluar. Ai mund të ishte më i gjatë në debate e në diskutime dhe mund të kishte më tepër të ftuar, por, praktikisht, ne e kemi përmbyllur. Unë nuk dua të nisem nga pozita e egos time si drejtues i atyre mbledhjeve, por mendoj se ne e kemi përfunduar. Ndërkohë, në komisionet e tjera është bërë një punë, që mendoj se ka qenë shumë e thelluar. Edhe në Komisionin e Politikës së Jashtme, ku unë jam anëtar, e debatuaam këtë gjë me shumë përgjegjshmëri nga të gjitha palët. Aty kishte edhe deputetë joanëtarë të atij komision, të cilët kanë ardhur, kanë shfrytëzuar hapësirën që u jep Rregullorja për të qenë pjesë, për të bërë pyetje, për të diskutuar dhe formuluar opinione. Kështu që ky proces është mbyllur dhe unë jam dakord me atë që thotë kryetarja, që, nëse do të vinim në një mbledhje që nuk është dakordësuar nga të gjithë, atëherë, fatkeqësisht, do të ftonim disa njerëz, që ne të gjithë i njohim dhe kemi marrëdhënie individuale. Prandaj, unë, në emër të maxhorancës, ne nuk jemi dakord për ta bërë atë mbledhje. Kjo, sigurisht me reflektimin që në çdo rast tjetër të jemi edhe më të hapur për të bërë debate dhe dëgjesa më të gjera dhe të gjata.

Flutura Açka - Po, zonja Zhupa.

Ina Zhupa - Faleminderit!

Një e drejtë që Rregullorja na e ka dhënë është që të mos varemi nga kartonët e cilësdo maxhorance, është e drejta që 7 deputetë të vendosin për thirrjen e komisionit për seanca dëgjimore për çështje të ndryshme. Në qoftë se keni frikë nga e vërteta, në qoftë se keni frikë nga ata që janë edhe më të majtë sesa ju, por janë profesionistë, arkeologë, studiues shqiptarë, të cilët merren me trashëgiminë kulturore, ne si komision, pavarësisht se e kemi kaluar Butrintit me marrëveshje sekrete, seanca dëgjimore bëhet së pari në funksion të informimit parlamentar. Së dyti, në funksion të informimit të opinionit publik, dhe së treti, sepse na e lejon Rregullorja e Kuvendit. Kështu që, ne sa herë kërkojmë me rregull, me 7 firma seanca, ju keni detyrim që t'i bëni. Në rast se ju zgjidhni të bojkotoni mbledhjen, mbledhja do të bëhet edhe në formë konference, me mediat atje. Nuk ka asnjë problem, ju nuk na bllokoni dot. Ju mund të na bllokoni, se nuk zbardhet mbledhja në procesverbal, por e zbardhin mediat. Ne e bëjmë mbledhjen me media dhe e vazhdojmë si një konferencë me media, por është turpi juaj dhe i kësaj seance që ka frikë nga e vërteta.

(Deputeti Petro Koçi ndërhyt pa mikrofon.)

Rregullorja e këtij Parlamenti nuk ju jep asnjë të drejtë që të na hiqni...

(Deputeti Petro Koçi ndërhyt pa mikrofon.)

Është akt, nuk ka ndodhur ndonjëherë në këtë Parlament që opozitës t'i hiqet e drejta ligjore e përcaktuar në Rregullore për të ftuar me 7 firma deputetësh, personalitete, njerëz me interes të lidhur me punën e komisionit drejtpërdrejt. E kuptoj që koncesioni i Butrintit është një koncesion, për të cilin doni t'ia fshini aferën publiku. Nuk ia arritët dot dhe s'keni për t'ia arritur. Ne do ta zhvillojmë seancën dëgjimore në këtë komision, siç na e lejon Rregullorja dhe siç është në të gjithë traditën e këtij Parlamenti. Ju vërtet keni një rekord të zi, se keni votuar një marrëveshje sekrete, e cila nuk u votua në asnjë komision tjetër, as në Komisionin e Ligjeve që e kishte shqyrtimin para nesh, i cili e shtyu, sepse nuk mund të kishte marrëveshje sekrete. Ju nuk mund të fusni në rekordet e parlamentarizmit një ngjarje edhe më të rëndë ku nuk lejoni Neritan Cekën, Apollon Baçen, Auron Taren, Agron Alibalin, Rudina Jasinin dhe Giora Solar, që të dëgjohej në këtë komision, por të vendoset me forcën e kartonit. Kjo është e paimagjinueshme, e padëgjuar ndonjëherë sesi mund të keni frikë nga e vërteta dhe nga specialistët Ata nuk janë anëtarë të partisë Demokratike, ata janë njerëz profesionistë, që Partia Socialiste i ka vënë nëpër pozicione, njerëz që kanë votuar dhe kanë qenë drejtues të Partisë Socialiste. Ju sot keni frikë, sepse janë profesionistë, sepse flasin të vërtetën për atë që doni të bëni me koncesionin e Butrintin, t'ia jepni për 10 vjet një fondacioni privat.

Nuk më kishte shkuar kurrë në mendje dhe kur kryetarja e tha, sinqerisht mendova, ç'është kjo gjë që nuk e lejon Rregullorja? Vetëm një maxhorancë totalisht e kapur në panik dhe një maxhorancë, që nuk ka asnjë logjikë politike e shkel me të dyja këmbët Rregulloren e Kuvendit.

(Deputeti Petro Koçi ndërhyt pa mikrofon.)

Dhe të shkelë Rregulloren e Kuvendit nuk ka ndodhur ndonjëherë. Është e rëndësishme, që e para, ju të respektoni etikën në komision dhe, e dyta, të respektoni Rregulloren në komision.

(Debat pa mikrofon.)

Shumë faleminderit!

Flutura Açka - Një herë seanca dëgjimore është para kalimit të projektligjit në Parlament, kështu që ka logjikë të bëhet, plus te ne ka kaluar pa u parë, pra kemi disa defekte. Duam apo s'duam, ne duhet t'i pranojmë defektet e këtij komisioni. Megjithatë, për faktin se janë ata burra, me të cilët do të kemi nevojë të punojmë edhe nesër, nuk mund t'i sjellim këtu, kur nuk bëhet kuorumi i mbledhjes, se do të jetë turpshme për këtë komision. Unë kështu e

gjykoj. Ju bëj thirrje thjesht për respekt të tyre. Mund të mos keni fare respekt për opozitën dhe nuk ju detyron kush as politikisht, as etikisht, në asnjë formë tjetër, por moralisht para atyre njerëzve me të cilët ne krenohemi, një grusht njerëzish që e mbajnë Shqipërinë dhe thelbin e Shqipërisë, unë ju bëj thirrje njerëzore, por edhe në pozicionin që kam, që të mos e dështojmë atë mbledhje. S'kemi pse të bëhemi lajm, kur kemi të gjithë dashurinë dhe predispozicionin për t'i dëgjuar ata njerëz, qoftë edhe shumë vonë, por të paktën po i dëgjojmë, që dhe ata ta ndiejnë veten shumë komodë që ky komision po i dëgjon dhe po i respekton, sepse janë ndier si ishuj të largët që nuk i përfill askush.

Kështu që, nuk ju kushton asgjë të vini në mbledhje, në nderim të 5 njerëzve, të cilët do të flasin për Butrintin. Ajo çështje mund të jetë mbyllur dhe është mbyllur, por të paktën ne të bëjmë moralisht detyrën tonë. Si të dëshironi ju! Unë e kam shqetësim dhe po e them si shqetësim njerëzor, por edhe si shqetësim politik: ne nuk duhet të bëjmë që ajo dëgjuesë të dështojë, pavarësisht detyrimeve politike të secilit prej nesh, pikërisht për këtë raport që kemi me këta njerëz nga pikëpamja historike.

Në rregull?

Faleminderit!

Zoti Ajazi.

Besion Ajazi – Faleminderit kryetare!

Unë miqësisht do i bëj një ftesë koleges Zhupa, që të mos abuzojë as me kolegët që ka përballë, që jemi ne, dhe as me emra që nuk janë këtu, dhe as me histori që nuk kanë ndodhur dhe nuk do të ndodhin. Ne nuk kemi ndër mend t'i mbyllim gojën asnjë njeriu. Jemi komision shumë i hapur, aq komision i hapur dhe mirëkuptues, sa s'ka pesë minuta që shtuam 4 pika në rezolutë me propozim të deputetes të Partisë Demokratike. Të na akuzosh për mbyllje goje, për frikë dhe për turp, vetëm 5 minuta pasi ne jemi treguar shumë të hapur dhe shumë mirëkuptues, është të marrësh mikrofonin dhe të abuzosh edhe me ata që na dëgjojnë.

Këtë gjë, kolegja Zhupa ka javë apo ditë që e bën, është puna e saj, është përgjegjësia e saj, por të paktën në prezencën tonë nuk duhet ta bëjë, sepse, siç e shpjegova, nuk kemi si të tregohemi më të hapur dhe mirëkuptues, kur gjithçka në komision kalon në diskutime, në mirëkuptim dhe reflektohet edhe nëpër rezoluta. Tani, të thuash që ne do ta bëjmë, por ju keni trup, por ju keni frikë, këto nuk shkojnë, sepse është një procedurë që ne si komision e kemi mbyllur. Ne e kemi bërë procedurën që na përcakton Rregullorja e Kuvendit, e kemi marrë në diskutim projektligjin, kemi pasur autoritetet përkatëse, përgjegjëse këtu, ministren e Kulturës, e kemi pyetur, na është përgjigjur dhe në fund fare e kemi miratuar. Në rast se keni merak që këta persona shumë të nderuar, të cilët i shërbejnë kulturës, trashëgimisë kulturore, arkeologjisë

e të tjera, dhe që këta duhet të flasin, le t'i thërrasë komisioni përgjegjës. Nuk e di, s'jam i saktë 100% nëse ka ndonjë komision tjetër që nuk e ka kaluar projektligjin, por kam përshtypjen se komisioni përgjegjës e ka miratuar në parim dhe nuk e ka miratuar ende nën për nen. Përse duhet të bëhemi në pjesë e një procedure që nuk na takon?

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

E dashur, e kemi kaluar.

Flutura Ačka - Ju lutem, jo pa mikrofon.

Besion Ajazi – Jemi komision për dhënie mendimi.

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

Po s'e di ti nëse është gabim, apo jo!

Nuk vendos ti, e vendos Konferenca e Kryetarëve. Nuk vendos ti, as unë.

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

Flutura Ačka - Jo pa mikrofon, ju lutem!

Besion Ajazi – Ideja është që ne refuzojmë, ashtu siç tha edhe kryetari i grupit tonë këtu në komision, të bëhemi pjesë e një shfaqjeje, që ju keni ndër mend të bëni.

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

Nuk ka lidhje, mos përdor njerëz pa lidhje.

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

Me ata. Po, pse? Po, patjetër.

Ne si ligjvënës e kemi kryer detyrën tonë, atë që na e lejon dhe na tregon Rregullorja. Pra, e kemi marrë projektligjin në shqyrtim si komision për dhënie mendimi, ashtu siç e kanë marrë në shqyrtim edhe komisionet e tjera për dhënie mendimi, dhe në fund fare kemi miratuar projektligjin. Se doni ju të bëni politikë, ne nuk bëhemi pjesë e politikës dhe e farsave tuaja.

Faleminderit!

Flutura Ačka – Faleminderit, zoti Ajazi!

Zoti Spaho e ka fjalën.

Florenc Spaho - Në fakt, kryetare, në respekt të fjalës suaj dhe në nderin e këtij komisioni, thatë që të diskutojmë gjithçka të përbashkët, duke pasur bonsensin e të dy krahëve politikë. Mirëpo, siç e thashë edhe pa mikrofon, zonja Zhupa ka dëshirë që pa plotësuar minutazhin e të folurit nuk e lë këtë komision, dhe është e drejta e saj të përdorë fjalën në mënyrë më të mirë, por pa etiketime.

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

Më fal! Ti iu drejtove gjithë grupit tonë, duke na thënë: turp e të tjera, edhe ne mund të kemi turp për opozitën që kemi përballë apo në sa pjesë po ndahet, por nuk e përmendim dhe

të bëjmë politikë për këtë gjë. Në fakt, ajo që duhet të bëjë ky komision i nderuar është të bëjë politika për arsimin, për kulturën, për turizmin dhe për më gjerë sesa të bëjë politikë, se po të fillojmë të bëjë politikë, ju duhet të dini një herë të bëni politikat tuaja, pastaj të filloni të bëni politikë kundrejt nesh.

E dyta, diçka që vlen për t'u përmendur, patjetër të gjithë anëtarët e nderuar që ju dëshironi të ftoni janë asete për ne, asete për Shqipërinë dhe asete për kombin, nuk heqim asnjë presje, por kjo nuk do të thotë që duhet të shkelim rregullat e vëna nga ky Parlament i nderuar. Në qoftë se ju do të kishit dëshirën e madhe për të ftuar këta njerëz të mëdhenj, mund ta kishit bërë më përpara, jo tani, siç thotë shprehja: "U dukën bathët e priftit që në fillim". Pra, kjo do të thotë që, pasi u kalua me votim apo jo, se në fund fare këtu ndahemi (forca e kartonit na ka sjellë të gjithëve këtu, atë karton që na kanë dhënë qytetarët), ne nuk mund të bëjmë dëshirat e çdo deputeti, që kujtohet pasi kalojnë 3 javë apo katër javë nga disa...

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

Tani, më fal, mund të jenë edhe 7 që e kërkojnë...

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

Patjetër, edhe Rregullorja thotë që po nuk u plotësua kuorumi, mbledhja nuk bëhet.

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

Ne nuk e kemi ndarë mendjen, nëse do të vijmë apo s'do të vijmë, por ne nuk marrim urdhra nga ty apo...

(Deputetja Ina Zhupa ndërhyr pa mikrofon.)

Po, pra, nga Rregullorja, se kryetarja më të drejtë, dhe mos merr rolin e kryetares, tha do ta vendosim bashkë, nëse do të bëhet ajo seancë dëgjimore apo jo, që të jemi për t'i nderuar këta njerëz të nderuar. Gjithashtu, me të drejtë edhe nënkryetari i komisionit, që i përket maxhorancës e tha që kjo mbledhje nuk mund të bëhet për këtë arsye që i parashikon edhe Rregullorja.

Siç po thua që 7 deputetë me firmë mund të kërkojnë një mbledhje komisioni, atëherë po me firmë në qoftë se kjo mbledhje nuk bëhet, nuk do të thotë se po shkelet Rregullorja, por janë disa praktika dhe procedura ligjore më të rëndësishme se dëshira që ke ti. Po të flas në mënyrë miqësore, që të mos bëni një shou politik duke etiketuar Grupin Parlamentar të Partisë Socialiste me disa terma që nuk janë etike. Ka disa momente që edhe mund të tërhiqesh dhe të kërkosh falje, edhe për etiketimet, se janë pa vend.

Faleminderit, zoti Spaho!

Flutura Açka - Zonja Zhupa.

Ina Zhupa - Zonja kryetare, faleminderit!

Sapo u konsultova me këshilltarët ligjorë dhe konstatuam që është shumë e thjeshtë çështja, përderisa neni 36 i Rregullores, faqja 67 thotë: “Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen në rast se 1/3 e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë me shkrim”. Mund të jetë e vërtetë që në datën 17 maj ju mund të mungoni, por cilado qoftë data kur ne arrijmë kuorumin, pra për çfarëdolloj çështje tjetër, ata vijnë në atë ditë kur ju jeni në sallë dhe zhvillohet seanca. Asnjë çështje tjetër e rendit të ditës nuk trajtohet para se të mbyllet kjo çështje, pasi është një detyrim për komisionin. Pra, komisioni është i detyruar, do të thotë se komisioni nuk ka tagër të mos ta bëjë mbledhjen në rast se nuk arrihet kuorumi ditën e propozuar, se kjo është në Rregulloren e Parlamentit.

Pra, kjo gjë është zgjidhur pikërisht për këto raste kur mazhoranca mund të zgjedhë, në cilëndo mbledhje të ardhshme, kur planifikohet raporti i RTSH-së apo ditë tjetër, që nuk fillohet pa kryer seanca dëgjimore, që është kërkuar nga 7 deputetët e opozitës në këtë rast, apo kushdo qofshin 7 deputetët. Në këtë aspekt, thjesht do të jetë një inkonveniencë për njerëzit që do të vijnë në datën 17 maj, në qoftë se ju nuk do të paraqiteni, por sigurisht që ata do të lajmërohen për çdo mbledhje tjetër të komisionit cilado qoftë ajo dhe dëgjesa e tyre do të jetë pika e parë e rendit të ditës.

Unë nuk isha në dijeni që këtë e ka zgjidhur ligjvënësi, për të mos arritur në këto situata, kur mazhorancat me vullnet të njëanshëm bllokojnë seancat dëgjimore.

Faleminderit!

Flutura Aça - Faleminderit, zonja Zhupa!

Unë prandaj ju bëra thirrje shumë miqësore, për shkak se njerëzit për të cilët po flasim nuk janë lecka, që t'i përdorim sa herë të duam, ikë e hajde. Ju bëra një thirrje njerëzore mbi të gjitha, përpara gjithçkaje tjetër, si qytetare, si njeri që ju kam respektuar dhe kam luftuar me të njëjtat skalione, me këta njerëz për të mbrojtur kulturën shqiptare. Jua thashë, nuk na kushton asgjë të dëgjojmë 1 apo 2 orë 10 njerëz të mençur, të cilët do të flasin për kulturën shqiptare, qoftë edhe për informacion. Edhe për kaq mund ta bëni, nëse keni dëshirë. Nuk do të jetë seancë debati, nuk do të ketë debate, në qoftë se kalohet në debate, atëherë shkelet Rregullorja. Kjo do të jetë seancë dëgjimore me njerëz, të cilët do të flasin për çështje që kanë lidhje me kulturën. Mund të jetë tejkaluar Butrinti, por kjo s'ka rëndësi, rëndësi ka qëllimi dhe qëllimi është i mirë. Nuk mendoj se është me prapavijë politike, por thjesht ata njerëz duhet të respektohen, dhe të dihet që edhe ky komision shumë i rëndësishëm që ka lidhje me kulturën, i ka dëgjuar. Kështu që, unë ju bëj me të vërtetë thirrje që të mos bëni të dështoj data 17 maj, të tjerat pastaj, ju i dini vetë.

Faleminderit!

Zoti Koçi.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, dua të theksoj se çështja e Butrintit nuk është fare koncesion, por kjo është një shpikje politike për ta njollosur marrëveshjen. Marrëveshja nuk është fare sekret, s'ka qenë as atë ditën kur është bërë mbledhja e komisionit, pasi ka qenë e depozituar në Kuvend dhe cilido deputet apo deputete kishte mundësinë ta shikonte për ta shqyrtuar në imtësi marrëveshjen. I vetmi element që mungonte ishte i ashtuquajti "plan biznesi", që hyn në konceptin e sekretit tregtar, të cilin unë nuk e pranoj, ngaqë nuk jam i fushës, mbase e kam gabim, por është një standard që përdoret. Unë jam për një transparencë totale edhe për të dhënat financiare të të gjitha subjekteve në Shqipëria me oligarkë dhe jooligarkë. Ky është një rregull që e ka shpikur bota, që për mua është i shëmtuar, por gjithsesi ky është një konvencion që unë nuk e pranoj, se është bërë i përgjithshëm dhe sundues.

Tjetra, në këtë rast *siti* arkeologjik i Butrintit nuk është një çështje shkencore, por është një çështje menaxhimi. Menaxhimi është nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan, i cili nuk është një fondacion antishqiptaro-amerikan. Ky menaxhim nuk i cenon fare të gjitha përcaktimet shkencore mbi autenticitetin dhe përcaktimet e origjinës dhe të kulturës që përfaqëson ky *siti* arkeologjik.

Gjithashtu, çdo lloj gërmimi i mëtejshëm arkeologjik do të bëhet gjithmonë nën autoritetin e Institutit të Arkeologjisë. Unë e kuptoj që këtu ka njerëz që, për shkak të egos profesionale e të tjera, janë kundër kësaj *status quo-je* të deritanishme. E kuptoj shumë mirë. Pjesa që i jepet për menaxhim fondacionit, që siç e thashë nuk është antishqiptaro-amerikan, është pjesa e *siti*, nuk është parku. Ato ndryshimet në kufijtë e parkut, nuk kanë lidhje fare me këtë marrëveshje. Është hequr nga parku vetëm pjesa e urbanizuar e Ksamilit, vetëm ajo është hequr, sepse këtu ka lloj-lloj akuzash, nga më të ndryshmet. Kështu që, mbledhja që ne bëmë ka qenë komplet e rregullt.

Sigurisht që ne mund të kishim vazhduar më të gjatë me shqyrtimin e projektligjit dhe të marrëveshjes, por nëse ka një akt të shëmtuar të asaj dite, ishte sjellja e pahijshme e një anëtareje të këtij komisioni dhe ajo sjellje e prishi mbledhjen. Unë individualisht kisha menduar që ajo mbledhje të mos përfundonte atë ditë, por të bënim sërish një diskutim tjetër. Ai incident e prishi komplet rendin e paravendosur, të paktën nga unë si drejtues i mbledhjes.

E thashë edhe një herë, së pari, ju nuk mund të na vendosni në pozita morale, fare. Unë nuk dua të shes mend tani, se kush nga ne është më shumë patriot se tjetri, fare. As turp, as frikë nuk kam. Unë po të kisha frikë, do të thosha: aman, të jem unë në mbledhje. Unë s'dua t'ia di. Për një mbledhje që vendos të mos jem, nuk ka bir nëne që më sjell këtu me presion,

me asnjë lloj presioni, nuk më sjell dot as me presion moral, as institucional, as financiar asgjë tjetër. Nuk mund të jem në një mbledhje, ku nuk dua të jem. Nuk na vendosni dot në pozita morale me njerëzit që propozohet të ftohen këtu.

Unë Neritan Cekën e kam mik shtëpie, qëkur ka qenë në Fier apo qoftë në marrëdhëniet që kemi pasur si ministër, si kolegë, si deputetë e të tjera. Mua nuk më vendos dot askush në pozitë. Askush nuk më vë dot në pozitë, duke më thënë: ju s'doni të dëgjoni figura të tilla. Jo, absolutisht jo. E takoj Neritanin, bëjmë debate, kemi diskutime, vlerësime të përbashkëta, të ndryshme, të kundërta s'është problem fare. Kështu që, kam respektin maksimal për të gjithë emrat që janë propozuar të ftohen, por së pari, dua të respektoj procedurën e këtij komisioni. Ne e shqyrtoam projektligjin. Ka pasur debate, hamendje, hipoteza dhe pikëpyetje nga më të ndryshme, por ato janë hedhur në publik dhe janë diskutuar më me imtësi në komisionet e tjera. Mund të ishte edhe ky komisioni përgjegjës, dhe këtë gjë e kam thënë që në atë mbledhje, por nuk u caktua.

Nuk e ndryshoj dot unë. Edhe sikur ata ta kthejnë tani, unë nuk e pranoj. Pra, nëse do të ishte vendosur që në fillim të ishte ky komisioni përgjegjës, unë do të isha dakord, sepse mund të ishte ky komisioni përgjegjës. Është një gjë që nuk e ndajmë dot ne tani. Mund të ishte.

Unë nuk e kam vulën e së vërtetës dhe të them që të ishte ky patjetër, por kështu u vendos në Konferencën e Kryetarëve. E menduan më shumë si një çështje marrëdhëniesh ekonomike dhe ia lanë atij komisioni, por kjo nuk e cenon dinjitetin e këtij komisioni, megjithëse e kishte vetëm për dhënie mendimi, as dinjitetin e çdo deputeti, që mund të jetë pro apo kundër. Dinjitetin këtu e shkel etika e munguar, edhe në raport me njëri-tjetrin.

Është e papranueshme, dhe kjo është përsëritur në disa mbledhje radhazi, që një vajzë e re sillet këtu sikur jemi në fillimet e politikës në vitet 1991, kur njerëzit godisnin njëri-tjetrin me grushte dhe ofendime.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta tregoj ty dhe kujt do qoftë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu që, nëse duam të ecim normalisht, me konsensus dhe mirëkuptim në këtë komision, e para është etika në komunikim me njëri - tjetrin.

Unë nuk dua të them se është turp për një palë që është kundër kësaj. Unë mund të them tani se Shqipëria është sanduiç nga pikëpamja e trashëgimisë kulturore dhe ka interesa të tjera që nuk duan të modernizohet menaxhimi i trashëgimisë, por nuk e bëj këtë gjë, sepse nuk kam të drejtë, nuk e di dhe duhet të kem fakte konspirative në dispozicion.

Po, është një sanduiç dhe ka interesa të tjera, që ndoshta nuk duan të lejojnë që menaxhimi i këtyre aseteve të jashtëzakonshme të modernizohet, por të vazhdojnë të mbeten kështu.

E tha shumë mirë dje drejtori i fondacionit. Ata kishin financuar vënien e një biletarie elektronike, që brenda tre muajve i rriti të ardhurat në 240%, por pastaj filloi avazi ballkanik: nuk ka energji, u prish aparatura e lloj-lloj justifikimesh, që vetëm njerëzit që e kanë mendjen për të rrëmbyer diçka mund të shpikin.

Faleminderit!

Flutura Açka - Faleminderit, zoti Koçi!

Dua të bëj një sqarim të vogël, sepse dëgjova të thoshit që plani i biznesit ka qenë sekret.

Sipas fjalëve të zonjës ministre, këtu u tha që plani i biznesit është sekret, kurse në një studio të Televizionit Shqiptar tha se nuk ekziston një plan biznesi. Pra, plani i biznesit do të bëhet në vijim si tua dojë qejfi atyre që do ta marrin Butrintin.

Këtë e kisha thjesht për sqarim, jo politike.

Po, zonja Tase.

Eralda Bano (Tase) – Faleminderit, kryetare!

Në fakt, edhe unë dua t'u drejtohem të gjithë kolegëve që kam përballë. Mendoj se gjëja e parë që duhet të bëjnë deputetët e parlamentit shqiptar është të mbrojnë trashëgiminë kulturore të këtij vendi.

E para, duhet të jemi të gjithë shqiptarë dhe unë mendoj se Butrinti është një rast që nuk duhet të na kalojë kështu. Ne duhet të ishim komision përgjegjës dhe patjetër që duhet të ndikojmë në vendimmarrjen e qeverisë, sepse bëhet fjalë për Butrintin. Kjo nuk duhet anashkaluar.

Realisht, unë nuk e kam fare politike kërkesën, por thjesht atdhetare, sepse nuk na kushton asgjë të zhvillojmë një seancë dëgjimore me profesionistët e kësaj fushe.

Nuk na kushton asgjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, ata janë profesionistë të artit, kulturës dhe historisë së këtij vendi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

T'i dëgjojmë, sepse mbase kemi nevojë.

Petro Koçi - Është çështje menaxhimi.

Eralda Bano (Tase) – Kështu na ndodhi edhe me Teatrin.

Zoti Petro, nga deputetët e Shqipërisë këtu u miratua një ligj me të cilin u shemb Teatrin Kombëtar. E njëjta gjë po ndodh edhe tani.

Shkaku që Teatri Kombëtar nuk është sot është heshtja e të gjithë deputetëve atëherë. Kjo është historia e Shqipërisë, prandaj unë po ju bëj një thirrje jopolitike, por si shqiptar. Nuk na kushton asgjë t'i dëgjojmë profesionistët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë ju kushton juve t'i dëgjoni këta arkeologë, këta historianë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e para nuk e di.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne nuk i dëgjojmë dot pa pasur kuorumin, prandaj po ju bëj thirrje ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flutura Açka - Zonjushë Ulliri, fol me mikrofon ndezur, të lutem!

Petro Koçi – Nëse doni të thërrisni mbledhjen, thirrëni, por unë nuk vij.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flutura Açka - Ju lutem, këtë çështje e kemi diskutuar dhe sot është e treta apo e katërta herë që e diskutojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, por pa fyerje.

Andia Ulliri - Ju kërkoj ndjesë për komunikimin pa mikrofon!

E para, komisioni ynë ka treguar integritetin e duhur për shumë çështje që kanë pasur të bëjnë me identitetin kulturor të Shqipërisë dhe mendoj se ne duhet të vazhdojmë me këto ritme, madje, duhet të kemi performancë më të lartë për standardin politikbërës që na është besuar nga votuesit shqiptarë.

Pra, ne duhet të bëjmë transparencë më të plotë për qytetarët shqiptarë. Besoj se shumica jonë ka disa pyetje për çështje të ndryshme, të cilat nuk janë adresuar.

Pavarësisht se kolegu Koçi tha se kjo është një çështje menaxhimi, ne duhet të tregojmë se kjo çështje menaxhimi prek edhe çështje të tjera kulturore për një aset kombëtar, i cili nuk është i ruajtur vetëm si trashëgimi kulturore e Shqipërisë, por duke qenë se është e ruajtur nga UNESCO është trashëgimi kulturore botërore.

Ka pikëpyetje shumë të mëdha për këtë çështje. Nëse ne duhet të mendojmë që ky komision e ka apo jo të drejtën dhe detyrën për të zhvilluar një seancë dëgjimore me ekspertë, në gjykimin tim, kjo nuk është gjëja e duhur për t'u konsultuar bashkë këtu.

A duhet t'i ftojme tani ata ekspertë apo duhet t'i kishim ftuar më përpara, tanimë ftesa është bërë. Thirrjet për të bërë konsulta me ekspertët janë bërë që në seancën e parë të këtij komisioni, në mënyrë që ne si deputetë të një komisioni për çështjet e trashëgimisë kulturore

të kemi përgjigje të paktën për disa nga pyetjet që kanë lindur gjatë procesit në Komisionin e Ekonomisë, por edhe në komisionet e tjera që kanë trajtuar çështjen e Butrintit.

Pra, nëse qeveria e ka marrë vendimin për të vazhduar me planin e saj, edhe pse duket qartazi që e ka bërë, nuk na kushton asgjë të zhvillojmë një seancë për të marrë përgjigje për disa nga pyetjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me sitin arkeologjik, me ndërhyrjet që do të bëhen dhe çfarë mendimi kanë ata, në mënyrë që në fund ne të kemi një rezolutë të saktë.

Atëherë, për mendimin tim dhe të opozitës, kjo duhet të ndodhë dhe shpresoj shumë që kolegët të kenë konsensusin për këtë gjë. Nuk mendoj se çështje të tilla duhet të anashkalohen nga komisioni, që, me të drejtë, duhet të kishte qenë komision përgjegjës, por që iu kalua një komisioni tjetër për shkak se u cilësua si çështje e menaxhimit, siç tha edhe kolegu Koçi, gjë që është e pavërtetë. Duke qenë se kjo është një nga monumentet e kulturës që mbrohet nga UNESCO, pesha më e madhe duhet t'i takonte këtij komisioni.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Ulliri!

Po, zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Faleminderit, kryetare!

Po e marr fjalën pasi foli zoti Koçi. Siç e thashë, Rregullorja e Kuvendit e thotë taksative dhe është detyruese për komisionin dhe e vetmja gjë nga e cila mund të ndikohen kolegët e maxhorancës është dita dhe data. Pra, nuk janë në atë ditë. Kurdo që ata të vijnë dhe kurdo që ata të jenë, nuk do të ketë pikë tjetër në rendin e ditës, përveç kryerjes së këtij detyrimi që Rregullorja i vendos komisionit.

Kështu që, mendoj se do të ishte mirë të mos e shtyjmë në kohë, edhe në respekt të njerëzve që janë ftuar, edhe në respekt të Rregullores, sepse kështu thjesht tregojmë frikën për të dëgjuar dhe për t'u përballur me disa të vërteta.

Pavarësisht se, siç e pranuan vetë, Butrinti është trajtuar si një çështje ekonomike dhe është çuar te Komisioni i Ekonomisë, kjo nuk na ndalon ne si Komision përgjegjës për Kulturën, jo tani, por edhe sikur një vit më pas t'i thërrasim, të kuptojmë si po shkon menaxhimi në çdo kohë. Këtë gjë na e lejon Rregullorja dhe është gjëja më normale, aq më tepër kur akoma nuk është kaluar në votim.

Shumë nga kolegët këtu, duke dëgjuar, pyetur dhe marrë më shumë informacion nga specialistët, mund të vendosin që në seancë të votojnë ndryshe nga votimi që kanë bërë në komision dhe të mbështesin atë që thonë arkeologët, studiuesit, njerëzit që e njohin shumë mirë Butrintin. Nuk ka asgjë për t'u çuditur.

Për sa i përket etikës dhe kryerjes së procedurave në komision, dua t'ju kujtoj se mikrofonin në këtë komision përdoret sa është në përputhje me Rregulloren, por, mbi të gjitha, sa herë është për interesin publik dhe nuk është një mjet privat që mund të përdoret sa herë lind dëshira private e një personi, kushdoqoftë ai.

Kështu që, për ta sqaruar dhe për ta përfunduar në ato standarde, që i njeh shumë mirë, zoti Koçi, më vjen keq, por unë kam një formim tjetër nga ai i zotit Koçi, kam një karrierë tjetër nga karriera e tij dhe nuk ka njeri shanse të më qethë mua tullace apo të kem të tjera rekorde në politikën shqiptare.

Kështu që, kur të më drejtoheni mua, bëni mirë të mos më drejtoheni personalisht, por politikisht, sepse ndryshe mund të themi të tjera gjëra.

Faleminderit!

Flutura Aça - Faleminderit, zonja Zhupa!

Po.

Enslemvera Zake – Faleminderit, kryetare!

Dua të bëj edhe një saktësim të fundit në lidhje me atë që trajtuam sot. Rakorduar për tri pika që të përfshihen në rezolutë. Pra, nuk përmendëm Reporterët pa Kufi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e kemi përmendur të jenë pjesë e rezolutës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ramë dakord për tri pika. Në qoftë se kolegët e tjerë do të jenë dakord ta përfshijmë edhe këtë pjesë, ...

Flutura Aça – Kemi votuar edhe shtesën tuaj, edhe shtesën e zonjushës Ulliri, edhe të Inës, që të përmirësohen aty ku kanë nevojë për përmirësime dhe aty ku duhet të futen si shtesa, do të bëhen shtesa.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Enslemvera Zake - Mbase isha unë e paqartë.

Kam edhe diçka tjetër. Në vijim të diskutimit, unë e kam thënë edhe në mbledhjen e kaluar, në Komisionin e Ekonomisë ne e kemi shqyrtuar të gjithë projektligjin, së bashku me planin strategjik, me marrëveshjen, planin e biznesit të Butrintit, ku kanë qenë të ftuar edhe kolegët e opozitës, të cilët kanë bërë pyetje dhe kanë marrë përgjigje nga ministrja përgjegjëse apo edhe nga përfaqësues të tjerë që kanë ardhur.

Në datën 9 maj, gjatë zhvillimit të mbledhjes së Komisionit të Ekonomisë, erdhi edhe kërkesa e një grupi deputetësh për ekspertët e fushës që mund të ishin të ftuar.

Kështu që, kjo kërkesë i është përcjellë Komisionit të Ekonomisë, kryetarit të komisionit dhe mbase është në vlerësimin e atij komisioni, si komision përgjegjës, në qoftë se do ta vlerësojë për të qenë prezentë në dëgjesë ekspertët e ftuar.

Faleminderit!

Flutura Aça - Faleminderit, zonja Zake!

Dëgjesa është bërë, por për specialistët është bërë me dyer të mbyllura, kurse për fondacionin është bërë me dyer të hapura. Ky është ndryshimi. Për këtë qasje po flasim ne. Ky është shqetësimi ynë. Për këtë qasje të pandershme po flasim ne, me dy agjenda. Nuk ka asgjë tjetër përveç kësaj.

Megjithatë, për ta përfunduar këtë çështje, falenderoj zonjën Tahiraj për leximin dhe ndërhyrjet!

Gjithashtu, falenderoj stafin! Ju lutem, përfshijini të gjitha shtesat për të cilat ramë dakord, që të dalim me një rezolutë të pastër, për ta përcjellë pastaj atje ku duhet.

Faleminderit!

Ditën e hënë do të kemi një dëgjesë me ministren Bora Muzhaqi. Shpresoj që, pas 6 muajve, të mos na tërheqë më zvarrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi dëgjesë me zonjën ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Orari do të vendoset në varësi të predispozicionit të ministres.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ia kemi lënë me bujari asaj që të zgjedhë kohën. Po të dojë, ne vijmë edhe në mes të natës, vetëm të tregojë respektin minimal duke ardhur në komision pas 6 muajve pritjeje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta bëjmë në momentin kur ajo të ketë kohën e përshtatshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Desantila Tahiraj – Kam edhe diçka të fundit.

Për sa i përket çështjes së Butrintit, meqenëse Ina dhe unë ishim relatores, ne kemi për të firmosur, bashkë me drejtuesin e seancës së asaj mbledhjeje, zotin Petro, materialin e përgatitur nga këshilltari.

Flutura Aça – Faleminderit!

Shihemi nesër!

MBYLLET MBLEDHJA

